

VENDIM
Nr. 312, datë 4.6.2025

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 690, DATË 2.9.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ZHVILLIMIT TË
GARËS, KRITERET SHITESË PËR APLIKANTËT QË KONKURROJNË PËR T’U
PAJISUR ME LICENCË PËR KATEGORINË “KAZINO”, E PROCEDURA E
SHPLLJES SË FITUESIT, SI DHE RASTET E REVOKIMIT APO TË PEZULLIMIT
TË KËSAJ LICENCE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 36, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III të vendimit nr. 690, datë 2.9.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të garës, kriteret shitesë për aplikantët që konkurrojnë për t’u pajisur me licencë për kategorinë “kazino”, e procedura e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence”, bëhen këto shtesa:

a) Pas shkronjës “ë”, të pikës 1, shtohet shkronja “f”, me këtë përmbajtje:

“f) Të jetë i certifikuar ose i klasifikuar në përputhje me përcaktimet e pikës 2, të nenit 35, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë.”.

b) Pas shkronjës “e”, të pikës 2, shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) Certifikatë klasifikimi me 5 vje ose vërtetim nga institucioni përgjegjës që konfirmon se struktura akomoduese përmbush kriteret e përgjithshme për t’u klasifikuar si hotel me 5 vje.”.

2. Ngarkohen Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku